



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Shërbime, riparime, ndërrime dhe pjesë këmbimi për mjetet e rënda të Agjencisë së Kullimit dhe Vaditjes, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44514200-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,214,650 (tre milion e dyqind e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 64,293 (gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 39% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”*;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet*

financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (shërbimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për shërbime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 19 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg, bazuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga QKB, Kodi: VII.3.B.1 “*Autoriparim i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiator*”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016, “*Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin si më poshtë:

A. Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar në stafin e tij, të paktën:

1 (një) Inxhinier mekanik/teknik/mekanik transporti, në detyrën/rolin e drejtuesit teknik.

Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomë perkatëse si dhe kontratën e punës ku te jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik si dhe te figurojë në listëpagesa për të paktën periudhën muajn e fundit të deklaruar.

B. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 4 (kater) punonjës, pjesë të stafit ose të kontraktuar, sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) xhenerik
- 3 (tre) punonjes ndihmes

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqiten kontratat individuale te punes të vlefshme.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë një drejtues teknik për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

Gjithashtu referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocise, te sistemeve drejtimit, etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si xhenerikë, dhe punonjes ndihmes e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **5 (pesë) persona**, vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen muajin e fundit të deklaruar.
- b.** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, per periudhen muajin e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore te te nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhen muajn e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese per AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marre ne konsiderate se rendesine e ktij sherbimi per AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te disponoje 1 (një) Rimorkiator, i cili do të shërbejne për te bere te mundur transportimin e mjeteve nga vend bllokimi i tyre deri në servis sipas kerkesave të AK, ne pronesi te tij ose te marrë me qera.

Për mjetin në pronësi te paraqiten:

- Certifikata e pronesise/ leje e qarkullimit
- Kontrolli teknik SGS (i vlefshem)
- Taksat e mjetit të paguara (të vlefshme)
- Siguracioni (i vlefshem).

Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me:

- Kontraten e Qerasë,
- Certifikaten e pronesise/ lejen e qarkullimit,
- Kontrolli teknik SGS (i vlefshem)
- Siguracioni, (i vlefshem).
- Taksat e mjetit të paguara (të vlefshme).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu sqarojme se mjeti është i domosdoshem pasi nevojitet për të bërë të mundur transportimin e mjeteve të rënda nga vend bllokimi i tyre deri në servis si dhe nga servisi tek Autoritetit Kontraktor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si me poshte:

- a) Fletë garancinë e mallrave ose deklaratë, ku të deklarohet marrja përsipër e garancisë së mallit prej jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga momenti i venies në punë.
- b) Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsipër transportin e automjeteve të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, me rimorkiator me shpenzimet e tij.
- c) Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsipër shërbimet dhe riparimet të kryhen në vendin e punës të ekskavatoreve (mjeteve të rënda) duke përjashtuar rastet e domosdoshme.
- d) Ofertuesi duhet të deklarojë se në servis disponon grope shërbimesh për automjetet e rënda.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.4.2 Ofertuesi duhet të disponojë në pronësi / me qira ose kontratë bashkepunimi një pike servisi jo më larg se 20 km nga Bashkia Kurbin ku përfshihen: ambiente oficine, ambiente për magazinimin e pjeseve të këmbimit (e verifikueshme nga KVO në ekstraktin e QKB-se në mënyrë elektronike)

Kriteri i distancës kërkohet për shkak të specifikës së objektit të prokurimit (janë mjete të rënda) pasi kontraktimi me një pike servisi me të largët do të shkaktojë kosto ekstra në buxhetin e Bashkisë Kurbin (karburant, kohe punë të burimeve njerëzore).

Per te provuar disponimin e pikes se servisit OE duhet te paraqese:

- Ne rast te disponimit te pikes se servisit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e tij
- Ndersa per piken e servisit te marre me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ huaperdorjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në nje pike servisi jo me larg se 20 km nga Bashkia Kurbin.

Ky kriter eshte vendosur per te provuar disponueshmerine e pikes se servisit jo me larg se 20 km, nga Bashkia Kurbin, ku gjenden mjetet e Agjencisë së Kullimit dhe Vaditjes (mjetet e renda) dhe per te garantuar ekzekutimin me sukses te kontrates, nese operatori shpallet fitues. Percaktimi i distances prej jo me shume 20 km nga vendodhja e mjeteve eshte vendosur per te bere te mundur mos shkaktimin e kostove ekstra ne buxhetin e Bashkise Kurbin (karburant, kohe pune te burimeve njerezore).

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik te jete i certifikuar per cilesine. të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Shënim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në*

shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kerkese ne rruge elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do te jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2597 Prot, date 03.06.2024 “Kërkesë për shërbime, riparime, ndërrime dhe pjesë këmbimi për mjetet e rënda të Agjencisë së Kullimit dhe Vadiçjes, Bashkia Kurbin”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

➤ **Te dhenat e automjeteve jane si me poshte:**

A- Eskavatori “CASE 1188 LC”, viti i prodhimit 1997, Nr.Shasie CGG0129964.

A- Eskavatori “BENATI 3.16” me goma, viti i prodhimit 1993, me Nr.Shasie 4R5256.

B- Eskavatori “VOLVO 220”, viti i prodhimit 2015.

C- Rimorkiatori i mjeteve të rënda.

➤ **TERMAT E REFERENCËS**

• **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Detyrat:**

Qëllimi i këtij shërbimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të renda dhe për furnizim vendosje (pjesë ndërrimi etj) të konsumit dhe venia në efikasitet sipas elementeve të preventivit të shërbimit.

- “**Autoriparim**” është *riparimi dhe mirëmbajtja* e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, pjesë ndërrimi etj.

- “**Veprimtari të riparimit**” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impianteve e të komponenteve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjedesh me motor.

- “**Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove**” është mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karrocisë, të impiantit elektrik dhe të gomave.

- “**Agregat**”: përbëhet nga shumë pjesë këmbimi të ndryshme të lidhura në çiftëzime, të lëvizëshme dhe të palëvizëshme për të kryer një proces pune të caktuar e cila ka një vlerë monetare relativisht të lartë (p.sh. agregati i motorit, kutia e shpejtësisë, ridoto, diferencial).

- “**Paijsja**”: përbëhet nga disa pjesë këmbimi të çiftëzuara, që kryen një punë të caktuar dhe ka një vlerë relativisht mesatare (p.sh. pompa të ndryshme, motorino, alternator, amortizator transmesion etj).

- “**Pjesë këmbimi**”: përbëhet nga një ose më shumë detale dhe kryen një funksion të caktuar dhe ka një vlerë relativisht mesatare (p.sh. koka paraleli, koka avantreni, krah të ndryshëm, ferrota freni, ingranazhe, kushineta, premistop, gomina etj).

➤ **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

• **Të përgjithshme:**

- Pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja , të pa përdorura dhe prodhim sipas standardit CE.
- Pjesët e këmbimit duhet të kenë garanci jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga momenti i vënies në punë të tyre.
- Ofertuesi duhet të paraqesë fletë garancinë e mallrave ose deklaratë, ku të deklarohej marrja përsipër e garancisë së mallit prej jo më pak se 6 muaj nga data e lëvrimit të mallit.
- Shoqëria kontraktuese, mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje të pjesëve edhe kur defekti/mospërputhja shfaqet gjatë procesit të montimit/riparimit.
- Shoqëria kontraktuese, pas marrjes së njoftimit për **mospërputhje ose defekt** duhet të zëvendësojë mallin ose pjesën menjëherë dhe gratis.

- Të gjitha pjesët të kenë të etiketuar, numrin e referencës (kodin e pjesës) (Serisë) dhe vendin e prodhimit të tyre.
- Pjesët e këmbimit duhet të jenë të ambalazuara.
- Pika e servisit të jete jo me larg se 20 km nga Bashkia Kurbin ku perfshihen: ambiente oficine, ambiente për magazinimin e pjeseve të këmbimit. Kriteri i distancës kërkohej për shkak të specifikës së objektit të prokurimit pasi kontraktimi me një pikë servisi me të largët do të shkaktonte kosto ekstra në buxhetin e Bashkisë Kurbin (karburant, kohe punë të burimeve njerëzore), si dhe duke qenë se janë mjete të rënda shërbimet dhe riparimet do të kryhen në vendin e punës të ekskavatoreve (mjeteve të rënda) duke përjashtuar rastet e domosdoshme.
- Afati i shërbimit të jete me shtrirje kohore deri në fund të vitit por shërbimi pranohet nëse kryhet edhe më para këtij afati.
- Likuidimi do të bëhet në situacione pjesore.
- Ofertuesi duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 5 (pesë) punonjës për të kryer shërbimin. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij ose të kontraktuar për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës 1 (një) Inxhinier Mekanik (Drejtes Teknik) dhe personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si: Xhenerik 1 (një), dhe punonjes shërbimi 3 (tre).
- Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsipër transportin e automjeteve të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, me karrotrec/rimorkiator me shpenzimet e tij.
- Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsipër shërbimet dhe riparimet të kryhen në vendin e punës të ekskavatoreve (mjeteve të rënda) duke përjashtuar rastet e domosdoshme.
- Ofertuesi në servis të ketë grupë shërbimesh për automjetet e rënda.

• **Specifikimet e vecanta të Vajrave dhe Graso:**

- 1- Origjina e mallrave të jetë brenda standarteve të BE.
- 2- Vaji të jetë i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare ACEA, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare, ekuivalente me to.
- 3- Vaji të jetë i ambalazhuar dhe jo me fuçi.
- 4- Graso Kostaline të jetë e ambalazhuar dhe jo me fuçi.
- 5- Vaji hidraulik CIS 68 të jetë i ambalazhuar dhe jo me fuçi, i destinuar për mjetin ekskavator “CASE 1188 LC“, prodhim i vitit 1997, Nr. Shasie CGG0129964 me zinxhirë.
- 6- Vaj hidraulik CIS 46 të jetë i ambalazhuar dhe jo me fuçi, e destinuar për mjetin ekskavator “BENATI 3.16“, prodhim i vitit 1993, Nr. Shasie 4R5256, me goma.
- 7- Vajrat janë llogaritur të nderrohen 2 herë për çdo mjet si dhe do mbetet vaj rezerve për shkak të difekteve që ndodhin gjatë punës (nga vjetërsia e mjeteve ndodhin carje të tubave të presionit të lartë).

Vaj hidraulik CIS 46

Nr	TREGUESIT	NJESIA	NORMA
----	-----------	--------	-------

1	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	0.86-0.89
2	Viskoziteti ne 40°C	cSt	43-46.3
3	Indeksi i Viskozitetit		<=100
4	Pika maksimale nxehtesise	°C	<=230
5	Materiale Mekanike	%/w	0
6	Tempratura e Ngrirjes	°C	<= -30
7	Konfeksioni	Lt	1

Vaj hidraulik CIS 68

Nr	TREGUESIT	NJESIA	NORMA
1	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	0,870
2	Viskoziteti ne 40°C	cSt	65-68
3	Indeksi i Viskozitetit		<=100
4	Pika maksimale nxehtesise	°C	<=240
5	Materiale Mekanike	%/w	0
6	Tempratura e Ngrirjes	°C	<= -30
7	Konfeksioni	Lt	1

Vaj motorri 20-50

Nr	TREGUESIT	NJESIA	NORMA
1	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	0.88-0.895
2	Viskoziteti ne 40°C	cSt	150-160
3	Viskoziteti ne 100°C	cSt	16.3-21.9
4	Indeksi i Viskozitetit		<=130
5	T.B.N	Mg KOH/g	9-12
6	Materiale Mekanike	%/w	0
7	Tempratura e Ngrirjes	°C	<= -30
8	Konfeksioni	Lt	4-5

Vaj Reduktori 80-90

Nr	TREGUESIT	NJESIA	NORMA
1	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	0.875-0.90
2	Viskoziteti ne 40°C	cSt	155-165
3	Viskoziteti ne 100°C	cSt	13.5-24
4	Indeksi i Viskozitetit		<= 110
5	T.B.N	Mg KOH/g	

6	Temraturaa e Flakerimit	°C	>188
7	Tempratura e Ngrirjes	°C	<= -20
8	Konfeksioni	Lt	1

- **Klasifikimi i Riparimeve:**

- Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),
- Riparime difektesh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),
- Riparime të përgjithshme (kthimi i agregatit në parametrat fillestar).

- **Të dhëna teknike për Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit:**

- Duhet të jenë të reja, të pa përdoruara dhe prodhim sipas standardit CE.

- **Shërbimi që kërkohet:**

- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit / mirëmbajtjes që rezultojnë jo sipas kushteve teknike dhe afateve të garancisë, të përcaktuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, sipas afateve të kryerjes së shërbimit.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrotrec/rimorkiator dhe pa pagesë shtesë.

- **Detyrat në lidhje me shërbimin:**

- Mjeti paraqitet në servis, nga përfaqësuesi/it e Autoritetit Kontraktor, ku mbasi i është kryer procesi i larjes, i nënshtrohet kontrollit teknik nga ana e specialistëve të Operatorit Ekonomik, ndersa në raste te vecanta operatori ekonomik shërbimet dhe riparimet di ti kryej ne vendin e punes te ekskavatoreve (mjeteve të rënda)
- Në prezencë të përfaqësuesit/ve te Autoritetit Kontraktor, Operatori Ekonomik mbasi ka kryer testimin e difektimit të mjetit, në paisjet përkatëse, evidenton difektet e mundëshme dhe përpilon preventivin teknik/situacionin.
- Gjatë procesit të riparimit përfaqësuesi/it e Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik kryen verifikimet e nevojshme në riparimet e kryera, pjesët e ndërrimit të zëvendësuara dhe kohën e harxhuar.
- Me përfundimin e riparimit të mjetit, personi/at përgjegjës, te autorizuar pranë servisit, njofton Autoritetin Kontraktor, për përfundimin e riparimit të mjetit, në mënyrë që të bëhet tërheqja e mjetit pranë servisit.
- Përfaqësuesi/it e Autoritetit Kontraktor paraqitet pranë servisit dhe bën verifikimin e shërbimit të kryer dhe pjesët e ndërrimit të zëvendësuara, sipas preventivit të miratuar. Nëse

të dy palët janë dakortësuar, mbi volumin e punimeve të kryera, hartohet procesverbal i përbashket, në tre kopje, në prani të përfaqësuesit/ve të Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik.

- Pas kontrollit të mjetit, në paisjet kontrolluese, dhe firmosjes së procesverbalit përfaqësuesi/it e Autoritetit Kontraktor tërheq automjetin nga servisi.
- Proçesi përfundimtar i riparimit të mjetit, krahas procesverbalit, shoqërohet me faturën tatimore dhe aktin e garancisë së riparimit.

Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës me përfundim deri me 31/12/2024 sipas nevojave të AK.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Sami Kulla Anëtar
3. Elvis Guraj Anëtar